



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Qershor 2022

Nr: 181

V E N D I M  
P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS  
“QENDRESA QYTETARE,” NDAJ Z. HAKI ÇAKO DREJTOR I PËRGJITHSHËM I  
AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE DHE ZJ. MAJLINDA ANGONI  
KANDIDAT PËR KRYETAR NË BASHKINË SHKODËR, PROPOZUAR NGA  
SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË” PËR ZGJEDHJET  
E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 30.06.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që i përket:

- Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”
- Objekt:** Aktivitet publik në kundërshtim me kufizimet e nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator
- Ndaj:** Z. Haki Çako, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Zj. Majlinda Angoni, Kandidat për kryetar në Bashkinë Shkodër
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, 172 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 23, 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë,



sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## VËREN:

### I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 26 Shkurt 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi me numër ID unik 3586, ku pretendohet se: *“Në datë 10.02.2022, në fshatin Obot, Drejtori i Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile, z. Haki Cako, së bashku me kandidaten e Partisë Socialiste për Kryetare e Bashkisë Shkodër, Znj. Majlinda Angoni, e cila kishte deklaruar më datë 07.02.2022 dorëheqjen nga posti i Prefektes së Qarkut Shkodër, kanë vizituar familjen Gocaj, duke premtuar përveç ndihmave materiale dhe nisjen e procedurave për ndërtimin e shtëpisë së djegur, nga ana e AKMC. Nga provat bashkëlidhur, shihet se është vënë në mbështetje të kandidates së PSSH, një organ publik dhe drejtuesi i këtij organi, në një dalje publike, në një kohë që në referim të vendimit nr. 2, dt. 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, përkon me periudhën e afateve proceduriale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme, i cili detyron institucionet publike të raportojnë aktivitetet me karakter publik që prej dt 31.01.2022, duke shkelur vendimet e Komisionit Rregullator dhe nenin 91 të Kodit Zgjedhor.*

*Ky takim është transmetuar nga media lokale TV1 Channel – Shkodër. Gjithashtu në shkelje të nenit 6, pika 3, të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, Z. Haki Cako, gjatë orarit zyrtar të punës, shfaqet pranë kandidates në zgjedhje në një veprimtari me karakter publik, aktivitet ky i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ.*

*Qendresa Qytetare kërkon marrjen e sanksioneve administrative bazuar ne nenin 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 10 të vendimit nr. 9, dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ndaj drejtorit të AKMC, ndaj subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidates Znj. Majlinda Angoni .*

Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike nga takimi si dhe provat në link.

1- <https://fb.watch/bpOiTB6DGq/>

2- <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=FY7tLoDy4Hs>

3- <https://ëëë.facebook.com/majlinda.angoni/posts/10222701056049219>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “P” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
  - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
  - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
  - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës
5. Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi “Qendresa Qytetare” përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako dhe kandidates për Kryetare Bashke zj. Majlinda Angoni, e propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
6. Referuar të denoncuarit subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, referuar vendimit nr. 19, datë 31. 05.2022 të KAS ku thuhet se *“në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie,*

por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ, pavarësisht se ajo ka qenë subjekt i denoncimit për këtë arsye nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrative.

## II. Rrethanat e faktit

7. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator mbi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në denoncimin e mësipërm pretendohet objekti i denoncimit i cili bie në kundërshtim me nenet 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor, si dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 1298 prot., datë 28.02.2022, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, zj. Majlinda Angoni dhe Partisë Socialiste të Shqipërisë, duke i kërkuar informacion sqarues në lidhje me denoncimin e bërë nga organizata “Qendresa Qytetare” mbi kryerjen e këtij aktiviteti.
9. Nëpërmjet shkresës me nr. 399/1 prot., datë 03.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1298/1 prot., datë 04.03.2022, jemi informuar nga z. Haki Çako Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) se, “Bazuar në ligjin nr. 45, datë 18.07.2013 “Për mbrojtjen civile”, AKMC ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikqyrës dhe kontrollues në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Vizita është kryer në përmbushje të detyrës funksionale dhe misionit të agjencisë. Gjithashtu, AKMC, referuar nenit 41 “E drejta e kompesimit”, përkatësisht pikës 4, kryen kompesimin e dëmeve të shkaktuar vetëm në rast se vlera e tij tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë dhe për këtë vendos komuniteti i mbrojtjes civile që kompesimi të kryhet nga AKMC. Sa më sipër, si dhe referuar ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008,

*“Për rezervat materiale të shtetit” si dhe shkresës së Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 125, datë 09.02.2022 “Kërkesë emergjente për mbështetje me bazë ushqimore dhe veshmbathje për z. Loro Gocaj” AKMC i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të rezervave materiale të shtetit të bëhej e mundur dhënia e ndihmave materiale për këtë familje. Pra, AKMC ka realizuar praktikat e dërguara nga prefekti”.*

10. Me vendimin nr. 146, datë 26.04.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Haki Çako, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe zj. Majlinda Angoni, propozuar si kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Shkodër nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”.
11. Nëpërmjet shkresës nr. 2414 prot., datë 17.05.2022, shkresa e sipërcituara u janë dërguar për njohje palëve të këtij denoncimi dhe sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9, datë 06.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, subjektet janë njoftuar për të paraqitur prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar. Brenda afatit të përcaktuar asnjë nga palët nuk ka paraqitur prapësime.
12. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve administroi si material të dosjes hetimore vendimin nr. 62 datë 11.02.2022 “Për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Shkodër të propozuar nga “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Majlinda Xhevdet Angoni për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.
13. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2522 prot., datë 31.05.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 31 Maj 2022, ora 13:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare”, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe zj. Majlinda Angoni. Për arsye të ndryshimit të agjendës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, seanca publike u shty për në datën 01.06.2022 ora 10:00 dhe palët u njoftuan nëpërmjet e-mail. Në seancë dëgjimore u paraqitën vetëm pala denoncuese organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti.

14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve filloi seancën dëgjimore duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur përfaqësuesit të organizatës “Qendresa Qytetare” e cila u shpreh se: *“Referuar denoncimit të raportuar në ndërfaqen e KQZ, në datë 10.02.2022, në fshatin Obot, Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, së bashku me kandidaten e Partisë Socialiste për Kryetare e bashkisë Shkodër, zj. Majlinda Angoni, e cila kishte deklaruar më datë 7.2.2022, dorëheqjen nga posti i Prefektes së Qarkut Shkodër; kanë vizituar familjen Gocaj, duke premtuar përveç ndihmave materiale dhe nisjen e procedurave për ndërtimin e shtëpisë së djegur, nga ana e AKMC. Sikurse shihet, është vënë në mbështetje të kandidates së PSSH, një organ publik dhe drejtuesi i këtij organi, në një dalje publike, në një kohë që në referim të vendimit nr. 2, datë 21.1.2022, të Komisionit Rregullator; përkon me periudhën e afateve procedural që lidhen me zgjedhjet e pjesshme, i cili detyron institucionet publike të raportojnë aktivitetet me karakter publik që prej datës 31.1.2022, duke shkelur vendimet e Komisionit Rregullator dhe nenin 91, të Kodit Zgjedhor. Ky takim është transmetuar nga media lokale TV1 Channel-Shkodër i cili konfirmon edhe karakterin publik të këtij ankitiviteti. Gjithashtu në shkelje të nenit 6, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, z. Haki Çako, gjatë orarit zyrtar të punës, shfaqet pranë kandidates në zgjedhje në një veprimtari me karakter publik, aktivitet ky i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ”. Referuar shkresës kthim-përgjigje të përcjellë nga z. Çako ku pretendon se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile nuk kishte dijeni lidhur me dorëheqjen e zj. Majlinda Angoni, është e pajustificueshme dhe nuk përjashton përgjegjësinë që z. Çako kishte, për të mos marrë pjesë në këtë aktivitet i cili konkretisht nuk u zhvillua me Prefektin, por me kandidatin për kryetar bashkie. Duke qenë në këto kushte, “Qendresa Qytetare” gjykon se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe kërkon konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenet 171 dhe 172, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator*
15. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoi palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare. Përfaqësuesi i organizatës “Qendresa Qytetare”, në përfundim të procesit administrativ, i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative të të denoncuarve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.



16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njoftoi zyrtarisht palët objekt denoncimi për zhvillimin e seancës dëgjimore të cilët janë shprehur se kanë marrë njoftimin me vonesë dhe nuk kanë mundur të paraqesin pretendimet e tyre. Duke qenë në keto kushte, Komisioneri vendosi riçeljen e hetimit administrativ duke i dhënë mundësinë palëve të shprehen lidhur me këtë çështje. Në seancën dëgjimore të datës 28.06.2022, u paraqitën pala denoncuese Organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile përfaqësuar me autorizim nga z. Jonian Harka, kandidati për Kryetar të Bashkisë Shkodër propozuar nga Partia Socialiste për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, zj. Majlinda Angoni dhe avokati i saj përfaqësuar me prokurë të posaçme z. Mariglen Legisi.
17. Organizata “Qendresa Qytetare” i qendroi pretendimeve të saj të parashtruara në seancën e kaluar. Përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile shprehet se i qendron argumenteve të paraqitura në formë shkresore gjatë hetimit ku pretendon se, *“Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm nuk është një aktivitet zyrtar, pasi nuk ka qenë e planifikuar si aktivitet publik. Ky takim është si çdo vizitë tjetër që kryen në familjet e prekura nga fatkeqësitë natyrore. Në këtë rast AKMC është angazhuar në këtë vizitë për të verifikuar koordinimin e institucioneve vendore dhe qendrore për t’i mundësuar kësaj familje kushtet minimale jetësore pas rënies së zjarrit në këtë banesë. Kjo vizitë nuk është bërë publike në rrjetet sociale apo në media për të informuar publikun. Akuzat se AKMC ka premtuar rindërtimin e banesës nuk qendron, pasi rindërtimi nuk është aspak kompetencë e saj. Qëllimi i vetëm ka qenë verifikimi për plotësimin e kushteve në përputhje me ligjin për mbrojtjen civile, pa patur asnjë ndikim politik”*.
18. Zj. Majlinda Angoni dhe përfaqësuesi i saj sqarojnë se, *“Prania e zj. Angoni nuk ka patur për qëllim takim elektoral, por është paraqitur si ish-prefekte apo banore e Shkodrës, pasi ka patur njohje të mëparshme me banorët e zonës. Prezenca e saj në këtë vizitë ka qenë për shkak të fatkeqësisë natyrore për familjen Gocaj dhe takimi me z. Haki Çako nuk ka qenë aspak i planifikuar, por ka qenë tërësisht rastësor. Në këtë takim u diskutua për t’u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë, pa patur për qëllim takim elektoral. Gjithashtu, vlerësojnë se bazuar në nenin 82, të Kodit të Procedurës Administrative dhe pikës 1 e 2, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor barra e provës në këtë rast i bie palës që ka iniciuar këtë procedurë administrative, pasi një intervistë formale apo një foto nuk provojnë shkeljen e asnjë prej pikave të pretenduara nga denoncuesi”*.
19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi dëgjoji palët në proces, përfundoi shqyrtimin në tërësi dhe hetimin administrativ duke kërkuar nga palët parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare.

Përfaqësuesi i organizatës “Qendresa Qytetare”, në përfundim të procesit administrativ, i qendroi pretendimeve të tij duke kërkuar marrjen e masave administrative të të denoncuarve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Përfaqësuesi i zj. Angoni kërkoj rrëzimin e pretendimeve të organizatës “Qendresa Qytetare”.

### III. Analiza ligjore

20. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, në kuptim të nenit 3, pika 2, të vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Rregullator, ka përcaktuar rrethin e subjekteve të cilët ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sipas përcaktimit të mëposhtëm:

*“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”.*

21. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson të rëndësishme të sqarojë se, për veprimtaritë e ndaluara, Kodi Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi subjektet zgjedhore. Kodi Zgjedhor, në pikën 20, të nenit 2 përcakton se “subjekte zgjedhore” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod. Pika 1, e nenit 172, përcakton se “...subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijeni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike



*dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë*”. Ndalimet ligjore që imponon Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 shtrihen edhe mbi subjektet zgjedhore. Nga analiza e fakteteve rezulton se zj. Majlinda Angoni ka marrë statusin e kandidatit për Kryetar Bashkie Shkodër, në datën 11.02.2022, nëpërmjet vendimit nr. 62 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Aktiviteti është kryer në datën 10.02.2022. Zj. Majlinda Angoni nuk gëzonte statusin e kandidatit për kryetar bashkie në kohën e zhvillimit të takimit, objekt i denoncimit. Të drejtat dhe detyrimet ligjore për zj. Majlinda Angoni nisin nga shpallja e vendimit që e ka regjistruar si kandidate. Në këto kushte, vlerësoj se ndaj zj. Angoni nuk mund të atribuojmë veprimtari administrative, të cilat janë specifikisht të ndaluara për t’u kryer nga subjekte të specifikuara në nenin 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020.

22. Të ndodhur në kushtet që zj. Majlinda Angoni nuk ka pasur statusin e kandidatit për kryetar bashkie, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, z. Çako nuk ka përdorur pozicionin e tij të punës dhe burime publike për t’i vënë në dispozicion të fushatës elektorale të zj. Angoni, pasi ajo nuk kishte marrë ende statusin e kandidatit për kryetar bashkie Shkodër, pra në këtë rast veprimtaria e kryer tek familja Gocaj nuk përbën një veprimtari me karakter publik. Nga sa u parashtrua nga përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile gjatë seancës dëgjimore, vizita e z. Haki Çako në familjen Gocaj, është zhvilluar në përmbushje të detyrave të tij funksionale, pa qëllime elektorale. Në analizë të fakteve dhe provave si dhe shpjegimeve të dhëna nga palët çmoj se, nuk jemi përpara një veprimtarie me karakter publik, dhe as një veprimtarie me karakter publik me qëllim promovimi. Në takim ka qenë familja e dëmtuar nga djegia e shtëpisë. Gjatë hetimit u pranua nga palët që media ka qenë e pranishme në fshatin Obot, tek familja Gocaj, por nuk u provua se me inisiativë të cilit prej pjesëmarrësve apo ndonjë pale të tretë media është njoftuar, ftuar apo ajo ka ardhur me inisiativën e saj në familjen Gocaj. U provua që veprimtaria e denoncuar nuk ka karakter publik, pasi jemi para një rasti konkret, ku dëmtimi dhe përfitimi nga shteti është për një familje të vetme dhe jo përfitim për kategori apo publikun më gjerë.
23. Për sa më sipër, nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se takimi në familjen Gocaj nga zj. Majlinda Angoni dhe z. Haki Çako ka qenë në përmbushje të detyrave të tyre rutinë e funksionale dhe nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “P” dhe “n”, pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23, 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

## V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Haki Çako Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe zj. Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, e propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022.
2. Moskonstatimin e shkeljes nga ana e z. Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe zj. Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, e propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 30 Qershor 2022

Nr. 181

“Për shqyrtimin e denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj z. Haki Çako Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe zj. Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, e propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”